



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Departamenti i Prokurimit

Data: 30.03.2023

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Lipjanit, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit për Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 8 (paragrafi 8.1.2) të Rregullave për Parashtrimin e Ankesave të aprovuara nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas kërkesës për ri-shqyrtim të datës: 27.03.2023, të parashtruar nga Grupi i OE “VIA EGNATIA SH.P.K. RR. “Mustafë Veselaj”, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “**Mirëmbajtja e rrugëve dhe trotuareve gjatë sezonit verorë (fshirja dhe larja) në qytetin e Lipjanit**” me nr. të Prokurimit: 613-23-253-2-2-1, nxjerr:

V E N D I M

I Refuzohet si e pa bazuar, kërkesa për ri-shqyrtim, VIA EGNATIA SH.P.K. RR. “Mustafë Veselaj, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “**Mirëmbajtja e rrugëve dhe trotuareve gjatë sezonit verorë (fshirja dhe larja) në qytetin e Lipjanit**” me nr. të Prokurimit: 613-23-253-2-2-1.

Mbetet në fuqi Njoftimi mbi Vendimin e AK-së, i bërë publik me datën: 21.03.2023

Prokurimi Publik i Komunës së Lipjanit

Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe do të publikohet për të gjitha palët në platformën elektronike në adresën : <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.

A r s y e t i m

Autoriteti kontraktues Komuna e Lipjanit ka filluar procedurat e prokurimit për aktivitetin e prokurimit me titull “**Mirëmbajtja e rrugëve dhe trotuareve gjatë sezonit verorë (fshirja dhe larja) në qytetin e Lipjanit**” me nr. të Prokurimit: 613-23-253-2-2-1.

Pas shqyrtimi të kërkesës për Ri-shqyrtim, pretendimet e OE ankues janë të pa bazuara dhe nuk qëndrojnë, pasi që OE i rekomanduar për kontratë ka paraqitur gjatë sqarimit fakte të mjaftueshme për pajisjet në fjalë, sipas sqarimit të bërë.

AK ka zbatuar me përpikëri rregullat e nxjerra nga KRPP

Drejtori i prokurimit bazuar në ato që u thanë më lart ka vendosur si në dispozitiv.

Këshilla juridike:

Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankesë pranë OSHP-së. Ankesa pranë OSHP-së duhet të dorëzohet brenda 10 (dhjetë) diteve pas pranimit të këtij vendimi.

Bekim Shabani


Drejtor i Prokurimit